



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

LIGJ

Nr. 128/2020

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 10440,  
DATË 7.7.2011, “PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS”,  
TË NDRYSHUAR<sup>1</sup>**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Neni 4 shfuqizohet.

Neni 2

Në nenin 5 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:

“a) projektet ose pjesë të projekteve, të përcaktuara në shtojcat I dhe II të këtij ligji, të hartuara për qëllimet e mbrojtjes kombëtare dhe/ose për përballimin e emergjencave civile, për të cilat argumentohet se vlerësimi i ndikimit të tyre në mjedis bie ndesh me qëllimet e mbrojtjes kombëtare dhe/ose përballimin e emergjencave civile;”.

2. Në shkronjën “b”, pas togfjalëshit “Ministria e Mbrojtjes” shtohet togfjalëshi “dhe/ose autoriteti përgjegjës për emergjencat civile” dhe pas togfjalëshit “e ndikimeve të rëndësishme

---

<sup>1</sup> “Ky ligj është përafëruar pjesërisht me:

- Direktivën 2011/92/BE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 13 dhjetor 2011 “Mbi vlerësimin e efekteve të disa projekteve publike dhe private në mjedis”, e ndryshuar”. Numri CELEX 32011L0092, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr.26, datë 28.1.2012, fq.1-21.

negative” shtohet togfjalëshi “të drejtpërdrejta ose jo në mjedis.”.

### Neni 3

Në nenin 6 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. “Vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM)” është procesi që kryhet për vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme, të drejtpërdrejta ose jo, në mjedis nga projekte të propozuara publike ose private nëpërmjet:

a) përgatitjes së raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis nga zhvilluesi;

b) kryerjes së konsultimeve sipas kërkesave dhe procedurave të përcaktuara në kreun III të këtij ligji;

c) shqyrtimit nga autoriteti kompetent të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe të çdo informacioni tjetër shtesë nga zhvilluesi, kur është i nevojshëm, si dhe të çdo informacioni tjetër të rëndësishëm, marrë nëpërmjet procesit të konsultimeve;

ç) përfundimit të arritur, të arsyetuar nga autoriteti kompetent, për ndikimet e rëndësishme në mjedis të projektit, duke marrë në konsideratë rezultatet e shqyrtimit të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis nga autoriteti kompetent dhe kur është e përshtatshme shqyrtimin e vet shtesë;

d) përfshirjes në vendimin e miratimit të zhvillimit të projektit nga autoriteti përgjegjës për miratimin e zhvillimit të përfundimeve të arritura të arsyetuara nga autoriteti kompetent.”.

2. Pikat 9, 10 dhe 11 ndryshohen si më poshtë:

“9. “Autoriteti ose autoritetet kompetente” është autoriteti ose autoritetet e përcaktuara si përgjegjëse për kryerjen e procesit të VNM-së, referuar detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj.

10. “Autoriteti përgjegjës për miratimin e zhvillimit” është institucioni publik që brenda fushës së përgjegjësisë që mbulon, funksioneve dhe kompetencave të përcaktuara në ligjin sektorial përkatës, është përgjegjës për miratimin e zhvillimit për projektet që janë objekt i këtij ligji.

11. “Zona të veçanta ruajtjeje” ka kuptimin që jepet në ligjin nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”.”.

3. Pas pikës 14 shtohet pika 14/1 me këtë përmbajtje:

“14/1. “Miratim zhvillimi” është akti i lëshuar nga autoriteti përgjegjës për miratimin e zhvillimit për projektet që janë subjekt i këtij ligji, që i jep të drejtë zhvilluesit të vijojë me zbatimin e tij.”.

4. Pas pikës 16 shtohet pika 16/1 me këtë përmbajtje:

“16/1 “Vlerësimi i duhur” është procesi që vlerëson rëndësinë e ndikimeve të një projekti të propozuar në mënyrë individuale apo në kombinim me planet ose projektet e tjera të miratuara, ose në zhvillim, në zonat e veçanta të ruajtjes, me qëllim informimin në proceset e vendimmarrjes.”.

### Neni 4

Në nenin 7 bëhen këto shtesa:

1. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Zhvilluesi, nëse është e nevojshme, kërkon mendim paraprak nga ministria ose AKM-ja nëse projekti që synon të zhvillojë është objekt i këtij ligji.”.

2. Pas pikës 5 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

“6. Ministri përgjegjës për mjedisin miraton me udhëzim shpjegimin e detajuar të projekteve të parashikuara në shtojcat I dhe II të këtij ligji.”.

## Neni 5

Në nenin 8 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Shkronja “ç” ndryshohet si më poshtë:

“ç) projektet e listuara apo jo në shtojcën I ose II të këtij ligji, që nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë, ose nuk lidhen domosdoshmërisht me menaxhimin e një zone të veçantë të ruajtjes, por që ka të ngjarë të kenë një efekt të rëndësishëm në këtë zonë, të cilat i nënshtrohen edhe vlerësimit të duhur, me qëllim sigurimin e autoriteteve kompetente, që këto projekte nuk do të sjellin pasoja në integritetin e zonës;”.

2. Pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:

“d) projektet e përcaktuara në shkronjën “ç”, që i nënshtrohen edhe vlerësimit të duhur, identifikohen rast pas rasti nga autoriteti përgjegjës për menaxhimin e zonave të veçanta të ruajtjes, referuar legjislacionit në fuqi për zonat e mbrojtura.

Në këtë rast, raporti paraprak i VNM-së përfshin edhe vlerësimin e duhur të përcaktuar në pikën 16/1 të nenit 6 të këtij ligji, të ndikimeve të këtyre projekteve në atë zonë, i cili shqyrtohet nga autoriteti përgjegjës për menaxhimin e zonave të veçanta të ruajtjes.”.

## Neni 6

Në nenin 9 bëhen ndryshimi dhe shtesat e mëposhtme:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Vlerësimi i ndikimit në mjedis i thelluar për projektet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, identifikon, përshkruan dhe vlerëson në mënyrë të përshtatshme, duke marrë parasysh secilin rast individual, ndikimet e drejtpërdrejta ose jo të projektit minimalisht në bazë të faktorëve të mëposhtëm:

a) popullsisë dhe shëndetit të njeriut;

b) biodiversitetit, me vëmendje të veçantë ndaj specieve dhe habitateve të mbrojtura, përcaktuar në aktet nënligjore për miratimin e listave të tipeve të habitateve natyrore, bimëve, kafshëve dhe shpendëve me interes për Bashkimin Europian dhe listës së shpendëve të egër veçanërisht vulnerable;

c) terrenit, tokës, ujit, ajrit dhe klimës;

ç) pasurive materiale, trashëgimisë kulturore dhe peizazhit;

d) ndërveprimet midis faktorëve të përmendur në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç” të kësaj pike.”.

2. Pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Ndikimet e përmendura në pikën 2 të këtij neni, në bazë të faktorëve të përcaktuar në të, përfshijnë edhe efektet e pritshme që rrjedhin nga prekshmëria e projektit ndaj rreziqeve të aksidenteve të mëdha dhe/ose të fatkeqësive natyrore, që janë të rëndësishme për projektin në fjalë”.

## Neni 7

Në nenin 11 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në pikën 1, togfjalëshi “një projekt i shtojcës II” zëvendësohet me togfjalëshin “një projekt i përcaktuar në nenin 8 të këtij ligji”.

2. Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. AKM-ja mund ta zgjasë afatin e marrjes së vendimit për VNM-në paraprake në raste të veçanta, që lidhen me natyrën, kompleksitetin, vendndodhjen ose madhësinë e projektit, deri në 1 muaj nga afati i përcaktuar sipas pikës 5 të nenit 7 të këtij ligji. Në këtë rast, AKM-ja informon zhvilluesin për arsyet e zgjatjes së afatit, si dhe për datën e marrjes së vendimit.”.

Neni 8

Në nenin 12, në pikën 1 togfjalëshi “autoritetit planifikues ” zëvendësohet me togfjalëshin “autoriteti përgjegjës për miratimin e zhvillimit”.

Neni 9

Në nenin 15, në pikën 1 togfjalëshi “në shkronjat “c”, “ç” dhe “dh”” zëvendësohet me togfjalëshin “në shkronjat “c”, “ç”, “d”, “dh” dhe “e””.

Neni 10

Titulli i kreut IV ndryshohet dhe bëhet “Dhënia e informacionit, ruajtja e të dhënave konfidenciale dhe konflikti i interesit”.

Neni 11

Neni 18 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 18

### **Dhënia e informacionit**

Autoritetet publike, me kërkesë të zhvilluesit apo të subjekteve të përcaktuara sipas nenit 24 të këtij ligji për hartimin e raportit të VNM-së, vënë në dispozicion të tyre informacionin e disponueshëm për përgatitjen e raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare dhe për mbrojtjen e mjedisit.”.

Neni 12

Pas nenit 19 shtohet neni 19/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 19/1

### **Konflikti i interesit**

Palët e ngarkuara për zbatimin e këtij ligji, duke përfshirë të gjithë aktorët që marrin pjesë në procesin e konsultimit, garantojnë një vendimarrje të paanshme, transparente, nëpërmjet parandalimit të konfliktit të interesit ndërmjet interesave publike dhe atyre private, sipas legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit.”.

Neni 13

Titulli i kreut V ndryshohet dhe bëhet “Vendimi i autoritetit përgjegjës për miratimin e zhvillimit”.

#### Neni 14

Nenet 20, 21 dhe 24 ndryshohen si më poshtë:

#### “Neni 20

### **Vendimi i autoritetit përgjegjës për miratimin e zhvillimit**

1. Autoriteti përgjegjës për miratimin e zhvillimit për një projekt publik ose privat të përcaktuar në këtë ligj, përpara vendimit për dhënien ose jo të miratimit të zhvillimit, sigurohet që projekti, i cili mund të ketë efekte domethënëse në mjedis, për shkak, *ndër të tjera*, të natyrës, madhësisë ose vendndodhjes së tij, t’u jetë nënshtruar kërkesave të këtij ligji dhe, në varësi të projektit, të jetë pajisur me deklaratë mjedisore ose vendim për VNM-në paraprake.

2. Autoriteti përgjegjës për miratimin e zhvillimit, kur shqyrton dhënien ose jo të miratimit të zhvillimit për një projekt ose vendosjen e kushteve për zhvilluesin, merr në konsideratë deklaratën mjedisore ose vendimin për VNM-në paraprake për ndikimet në mjedis të projektit të propozuar.

3. Në rast se autoriteti përgjegjës për miratimin e zhvillimit të projektit merr vendim për miratimin e zhvillimit të projektit në kundërshtim me vendimin për VNM-në paraprake apo deklaratën mjedisore, jep argumentet përkatëse për këtë vendim.

4. Akti për miratimin e zhvillimit duhet të përfshijë të paktën informacionin e mëposhtëm:

a) arsyetimin nga autoriteti kompetent për efektet domethënëse të projektit në mjedis, duke marrë parasysh rezultatet e shqyrtimit;

b) çdo kusht mjedisor të përcaktuar në deklaratën mjedisore ose në vendimin për VNM-në paraprake, përshkrim të karakteristikave të projektit dhe/ose masat e parashikuara për të shmangur, parandaluar ose zvogëluar dhe, nëse është e mundur, kompensuar ndikimet e rëndësishme në mjedis, si dhe masat e monitorimit.

#### Neni 21

### **Miratimi i zhvillimit në zonat e veçanta të ruajtjes**

1. Autoritetet përgjegjëse për miratimin e zhvillimit japin miratimin përkatës vetëm në rast se vlerësimi i duhur ka konstatuar se nuk do të ketë efekte të konsiderueshme në integritetin e kësaj zone.

2. Kur projekti duhet të zhvillohet për arsye madhore të interesit publik kombëtar, pavarësisht nga ndikimet në zonë, të identifikuar në vlerësimin e duhur dhe mungesa e zgjedhjeve alternative, autoritetet përgjegjëse miratojnë zhvillimin vetëm me kushtin që zhvilluesi të marrë të gjitha masat kompensuese me qëllim sigurimin që zona e veçantë e ruajtjes nuk e humb integritetin e saj, duke marrë edhe mendimin e njësisë së vetëqeverisjes vendore ku do të zhvillohet projekti në bazë të planeve të zhvillimit në atë zonë.

## Neni 24

### **Certifikata për hartimin e raportit të VNM-së**

1. Zhvilluesi për përgatitjen e raportit paraprak dhe raportit të thelluar të VNM-së ngarkon ekspertin e certifikuar nga ministri, i cili mund ta ushtrojë veprimtarinë si person fizik ose si person juridik.

2. Të drejtën për përgatitjen e raportit paraprak dhe raportit të thelluar të VNM-së e kanë subjektet:

a) personi fizik, i cili është certifikuar si ekspert nga ministri;

b) personi juridik, administratori i të cilit është certifikuar si ekspert nga ministri dhe ka të punësuar me kontratë pune të paktën edhe 1 ekspert të certifikuar nga ministri.

3. Subjektet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni hartojnë raportin e VNM-së duke krijuar grup specialistësh të kualifikuar, sipas fushave përkatëse që trajton raporti i VNM-së. Raporti i VNM-së nënshkruhet nga personi fizik/juridik dhe specialistët e përfshirë në hartimin e raportit të VNM-së.

4. Rregullat, procedurat dhe kriteret për pajisjen me certifikatën e ekspertit për vlerësimin e ndikimit në mjedis, ekspertizën mjedisore dhe auditimin mjedisor miratohen nga Këshilli i Ministrave me propozimin e ministrit. Ministri lëshon certifikatën.

5. Subjektet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni duhet të kenë të regjistruar në regjistrin tregtar si objekt veprimtarie hartimin e raporteve të VNM-së.”.

## Neni 15

Titulli i kreut VIII ndryshohet dhe bëhet “Ankimi, monitorimi, vlefshmëria, kundërvajtjet administrative dhe sanksionet”.

## Neni 16

Neni 25 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 25

### **Ankimi**

1. Çdo palë e interesuar, përfshirë edhe publikun e ndikuar, subjekt i këtij ligji, ka të drejtë të ankohet te ministri për aktet administrative të nxjerra prej tij dhe tek AKM-ja për aktet administrative të nxjerra prej saj.

2. Ankimi ndaj mosveprimit administrativ drejtohet te ministri dhe tek AKM-ja. Në rastin kur ankimi është paraqitur tek AKM-ja, kjo e fundit është e detyruar ta përcjellë te ministri, si organ epror, së bashku me dosjen dhe arsyet e mosveprimit, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative.

3. Me qëllim rritjen e efektivitetit të dispozitave të këtij neni, ministria dhe AKM-ja publikojnë në faqen zyrtare elektronike informacionin mbi të drejtën e publikut të ndikuar për të drejtën e ankimit administrativ dhe gjyqësor.”.

## Neni 17

Pas nenit 25 shtohet neni 25/1 me këtë përmbajtje:

### **Monitorimi dhe vlefshmëria**

1. AKM-ja përcakton llojin e parametrave që monitorohen dhe kohëzgjatjen e monitorimit në raport me natyrën, vendndodhjen dhe madhësinë e projektit e të ndikimeve të rëndësishme të tij në mjedis, të cilat parashikohen në vendimin për VNM-në paraprake apo deklaratën mjedisore.

2. Zhvilluesi, gjatë fazës së zbatimit të projektit, kryen vetëmonitorimin e ndikimeve të rëndësishme të projektit në mjedis dhe i raporton AKM-së për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit.

3. Struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e mjedisit inspekton ndikimet në mjedis nga zbatimi i projektit, si dhe kushtet e monitorimit të përcaktuara në vendimin për VNM-në paraprake apo deklaratën mjedisore.

4. Deklarata mjedisore apo vendimi për VNM-në paraprake për projektin e propozuar është e vlefshme për aq kohë sa është i vlefshëm edhe dokumenti i miratimit të zhvillimit për projektin.

5. Nëse projekti, që i është nënshtruar procesit të VNM-së, nuk fillon zbatimin në terren brenda 2 vjetëve nga data e miratimit të deklaratës mjedisore apo të vendimit për VNM-në paraprake, atëherë këto dokumente konsiderohen të pavlefshme dhe procesi i VNM-së fillon nga e para.”.

Neni 18

Neni 26 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 26

### **Kundërvajtjet administrative dhe sanksionet**

1. Shkeljet e mëposhtme të këtij ligji, që nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

a) zhvilluesi i një projekti, i cili listohet në shtojcat I dhe II të këtij ligji, nëse operon pa u pajisur me vendim për VNM-në paraprake sipas parashikimit të nenit 8 të këtij ligji, ose me deklaratë mjedisore sipas parashikimit të nenit 9 të këtij ligji, dënohet me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë dhe me pezullimin e punimeve.

b) mospërmbyshja dhe mosrespektimi i kushteve të vendimit për VNM-në paraprake ose deklaratës mjedisore nga zhvilluesi i projektit:

i. për vendimin për VNM-në paraprake dënohet me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 200 000 (dyqind mijë) lekë;

ii. për deklaratë mjedisore dënohet me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë.

2. Shfuqizohet akti administrativ nga autoriteti kompetent në rast se vërtetohet paraqitja e fakteve, të dhënave dhe dokumenteve të rreme nga zhvilluesi apo nga subjektet e përcaktuara sipas nenit 24 të këtij ligji për hartimin e raportit të VNM-së, të cilat kanë ndikuar në vendimmarrjen e autoritetit kompetent.

3. Krahas dënimit me gjobë, të parashikuar në shkronjën “b” të pikës 1 të këtij neni, në rast të mospërmbyshjes dhe mosrespektimit nga ana e zhvilluesit të kushteve të përcaktuara në vendimin për VNM-në paraprake ose deklaratën mjedisore:

a) AKM-ja për vendimin e VNM-së paraprake pezullon aktivitetin për zbatimin e projektit nga 1 deri 12 muaj deri në zbatimin e kushteve;

b) ministri, për deklaratën mjedisore, me propozim të AKM-së, pezullon aktivitetin për zbatimin e projektit nga 3 deri 12 muaj deri në zbatimin e kushteve.

4. Në rast të pezullimit të vendimit për VNM-në paraprake ose deklaratës mjedisore, të përcaktuara në pikën 3 të këtij neni, zhvilluesi dorëzon në AKM për shqyrtim dhe miratim jo më vonë se 30 ditë nga data e marrjes dijeni të aktit të pezullimit dokumentet e mëposhtme:

a) raportin e detajuar për dëmin e shkaktuar, ku përfshihen masat e marra për parandalimin e dëmeve të mëtejshme;

b) planin e rehabilitimit me qëllim kompensimin e dëmit të shkaktuar në terma konkretë, ku përcaktohen masat dhe kohëzgjatja e realizimit të këtij plani.

AKM-ja pas shqyrtimit të dokumenteve të përmendura në shkronjat “a” dhe “b”, i kërkon zhvilluesit ndryshime ose i komunikon miratimin duke i përcjellë një kopje të tyre edhe njësisë së vetëqeverisjes vendore ku zhvillohet projekti.

5. Pas rehabilitimit të zonës, referuar dokumenteve të përcaktuara në pikën 4 të këtij neni, zhvilluesi dorëzon raportin për zbatimin e planit të rehabilitimit dhe i kërkon autoritetit kompetent shfuqizimin e aktit të pezullimit, duke bërë gjithashtu me dije edhe njësinë e vetëqeverisjes vendore.

6. Në rast të konstatimit se zona nuk është rehabilituar, AKM-ja shfuqizon vendimin e VNM-së paraprake dhe në rastin e deklaratës mjedisore shfuqizimi bëhet nga ministri, me propozim të AKM-së.

7. Në rast të konstatimit nga AKM-ja se akti i miratimit të zhvillimit është bazuar në një projekt, karakteristikat kryesore të të cilit janë ndryshuar në një masë të tillë që do të sillte efekte domethënëse nga ato mbi të cilat është bazuar vendimmarrja për vendimin për VNM-në paraprake ose deklarata mjedisore, ministri propozon pranë autoriteteve përgjegjëse shfuqizimin e aktit të miratimit të zhvillimit.

8. Në rast të paraqitjes nga subjektet e përcaktuara sipas nenit 24 të këtij ligji për hartimin e raportit të VNM-së mbi 3 herë të raporteve me mangësi, bazuar në metodologjinë kombëtare për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, ministri vendos pezullimin ose heqjen e certifikatës së ekspertit.

9. Në rastet kur shkeljet përbëjnë vepër penale, struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e mjedisit bën kallëzim penal pranë organeve përkatëse.

10. Procedura e konstatimit, vendosjes dhe ankimit të masave administrative, si dhe ekzekutimi i tyre bëhen në përputhje me legjislacionin për kundërvajtjet administrative.

#### Neni 19

Kudo në përmbajtje të ligjit fjala “negative” hiqet.

#### Neni 20

### **Aktet nënligjore**

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të pikës 4 të nenit 24 të ligjit.



Neni 21

**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**K R Y E T A R I**

**Gramoz RUÇI**

Miratuar në datën 22.10.2020